

STATUT I SHOQERISE
“SELECT GROUP” Sh.p.k

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 26 Dhjetor 2023:

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miraton kete Statut si vijon:

KAPITULLI I
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1
Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte **“SELECT GROUP” Sh.p.k.**
Shoqeria **“SELECT GROUP” Sh.p.k** eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (me pas refeuar si “Ligji Tregtar”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.p.k).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit (me pas refeuar si “QKB”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 2
Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: Rruga Nacionale Tirane - Dajt, Km.5, Godine 4 kateshe, Select Hill Resort, ZK. 2380, nr. Pasurie 11/21/22, Lanabregas, Dajt, Tirane. Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

Neni 3
Objekti

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Hotel - Bar - Restorant. Tregti me pakicë e duhanit. Pishina verore, salle eventesh. Tregtimi i mallrave te ndryshem te konsumit te gjere, produkteve te gatshme, industrial, ushqimor, prodhime pylli, pije freskuese, restorant, operacione tregtare, komisioneri, transaksione te ndryshme import dhe eksporti. Hoteleri. Agjent/Agjenci udhetimi nderkombetar. Organizim grupesh turistike. Perfaqesi shitjesh dhe rezervimi udhetimesh online, organizator eventesh, catering, dasma dhe konferenca. Import export, tregti me shumice e pakice artikuj te ndryshem, shtypshkrime dhe botime te ndryshme, transporte, punime karpantjerie. Prodhim dhe tregtim material ndertimi, transport mallrash dhe pasagjeresh. Sherbime te marketingut dhe te reklames ne sherbim te shitjeve te

produkteve te ndryshme. Aktivitetet ne fushen e sherbimeve mobiliare dhe imobiliare. Pjesemarrje ne tenderat publike dhe private per ofrimin e sherbimeve dhe aktivitetet qe ushtron shoqeria. Bashkepunimin dhe bashkimin, shitjen dhe blerjen e kuotave apo aksioneve ne shoqeri te tjera qe ushtrojne aktivitet te njejte dhe te ngjashem me shoqerine. Shebime te ndermjetsimit dhe brokering per lidhjen dhe permbushjen e kontakteve ndermjet operatoreve lokale dhe atyre te huaja. Çdo aktivitet tjetër, qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartpermendura.

Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

Neni 4 Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete e pakufizuar. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100,000 (njqind mije) Leke.

Kapitali themeltar zoterohet nga ortaku i vetem themelues si vijon:

- **Z. Rigers Qefalia**, mbajtes i leternjoftimit ID nr. 032849976, numer personal J50514040M, zoterues i **1 (nje) kuote** me vlere 100,000 (njqind mije) Leke qe perben **100% te kapitalit themeltar te shoqerise;**

Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6 Kuotat Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij. Titulli i pronesise mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve i cili do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve (ne vijim “**Regjistri i Ortakeve**”).

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

Neni 7 Kalimi i Kuotave

Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.



Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji.

Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuota e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

Neni 9 Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE

Neni 10 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket

per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katermbledhete) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

Neni 11

Organi Administrues / Administratoret

Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Personi i meposhtem caktohen si Administrator i pare i shoqerise me mandat 5 vjeçar:

- **Z. Rigers Qefalia**, mbajtes i leternjoftimit ID nr. 032849976, numer personal J50514040M shtetas shqiptar, lindur me 14.05.1995.

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;

- (ii) perfaqesoje Shoqerine;
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti. Administratori mund te autorizojte persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategoria e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

Neni 12 Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeruje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13 Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjetë) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.
Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 14 Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 15 Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.



**KAPITULLI V
PRISHJA - LIKUIDIMI**

**Neni 16
Prishja e Shoqerise**

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

**Neni 17
Likuidimi**

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

**Neni 18
Dispozita Perfundimtare**

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesis, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne gjuhen Shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Z. Rigers Qefalia

